**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**POSTA SHQIPTARE SH.A**
Nr, 3307 prot.
Tiranë, më 18.12.2019

**QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN**
Nr, 264 prot.
Tiranë, më 11.12.2019

# MARRËVESHJE

# PËR

# SHËRBIMET POSTARE

Sot, më datë 11 /12 /2019, mbështetur në vullnetin e lirë të palëve dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nënshkruhet kontrata për kryerjen e shërbimeve postare midis palëve si më poshtë:

**Qendra e Botimeve për Diasporën**, me adresë: Rruga "Vilat Gjermane", Nr.6, 1003, Tiranë, përfaqësuar nga znj MIMOZA HYSA CULIQI dhe NIPT L91317451O, që këtu më poshtë do t'i referohemi si ***"Përfituesi i shërbimit"***
*dhe*

**Shoqëria "Posta Shqiptare" SH.A.,** me seli ne adresën Rruga "Rreshit Çollaku", Nr. 4, Tiranë, dhe NIPT J61924007N, përfaqësuar Z.Laert Duraj, Administrator që më poshtë do t'i referohemi si **"Ofruesi i Shërbimit".**
Së bashku referuar si **"Palët";**

## Baza ligjore

Kjo kontratë bazohet në nenin 945 e vijues, të Ligjit nr. 7850, datë. 29.07.1994 të "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në VKM Nr. 241, datë 31.3.2011 "Për kryerjen nga Posta Shqiptare sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qëndrore e vendore, institucionet e tjera publike si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror" i ndryshuar, në Ligjin Nr. 46, datë 07.05.2015 "Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Rregulloren "Për Shërbimin Universal Postar në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin Nr.446, datë 26.09.2002 "Për miratimin e tarifave postare të shërbimit bazë", i ndryshuar.

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë me kushtet dhe detyrimet e mëposhtme:

## Neni 1

## Përcaktimet

**1.1** Në termat e kësaj kontrate me përcaktimin "Përfitues i Shërbimit" do të kuptohet **Qendra e Botimeve për Diasporën,** ndërsa me përcaktimin "Ofruesi i Shërbimit" do të kuptohet **Posta Shqiptare Sh.A.**

1.2 Me termin "Shërbim" do të kuptohet proçesi i pranimit, përpunimit, transportit dhe dorëzimit të objekteve postare, sipas destinacioneve të përcaktuara nga Përfituesi i Shërbimit.

1.3 Me termin "Objekt" do të kuptohet çdo letër, zarf, paketë, koli, korrespondencë zyrtare përkatëse, e dorëzuar në zyrat e postës (apo e tërhequr nga shpërndarësi), përpunuar, transportuar dhe dorëzuar në destinacion.

## Neni 2
## Objekti i kontratës

Kjo kontratë përcakton kushtet për pranimin, përpunimin, transportin dhe dorëzimin në destinacion të objektit, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij, nëpërmjet të cilave të dy palët e saj, "Përfituesi i Shërbimit" dhe "Ofruesi i Shërbimit" bien dakort të realizojnë me anë të shërbimeve postare që kryen Ofruesi i Shërbimit për llogari të Përfituesit të Shërbimit si më poshtë:

1 **Shërbime universale dhe jo universale postare**
2 **Shërbim i shpejtë postar EMS (Express Mail Service) për jashtë vendit;**
3 **Shërbim i shpejtë postar brenda vendit (brenda qytetit dhe ndërmjet qyteteve).**

## Neni 3
## Të drejtat dhe detyrimet e palëve

### 3.1 Ofruesi i Shërbimit

### 3.1.1 Për shërbimet universale dhe jo universale postare

3.1.1.1 Të pranojë, të përpunojë, të transportojë dhe të dorëzojë në destinacion objektet e Përfituesit të Shërbimit, gjatë orarit zyrtar të Ofruesit të Shërbimit, për Tiranën dhe për gjithë territorin e vendit dhe jashtë tij, sipas normativave të Postës Shqiptare sh.a, ose kur është e veçantë në marrëveshje midis palëve.

3.1.1.2 Të kryejë shërbimin sipas sasisë, cilësisë dhe afatit të përcaktuar në kontratë.

3.1.1.3 Të trajtojë, të përpunojë, të dorëzojë e të tarifojë objektin, duke e kategorizuar si objekt postar:
- sipas grup peshës,
- llojit të shërbimit (i thjeshtë, i porositur).

3.1.1.4 Tarifat në fuqi për të gjitha llojet e shërbimeve të ofruara nga Ofruesi i Shërbimit janë bashkangjitur si **Aneks 1** dhe janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

3.1.1.5 Në rast të humbjes së objektit të Përfituesit të Shërbimit nga ana e Ofruesit të Shërbimit e vërtetuar kjo me reklamacion (kundrejt tarifës përkatëse), ky i fundit është i detyruar të paguajë dëmshpërblim sipas "Rregullores së Shërbimit Universal Postar në Republikën e Shqipërisë".

3.1.1.6 Ofruesi i Shërbimit, nuk mban përgjegjësi për mos realizimin e shërbimit apo vonesa në kryerjen e tij, në rast se nga ana e Përfituesit të Shërbimit nuk janë plotësuar të dhënat e mëposhtme:

- Adresa e marrësit nuk është e shkruar qartë dhe e plotë;
- Adresa është gabim;
- Kur amballazhimi nuk i përshtatet përmbajtjes së objektit, duke u bërë shkak për dëmtime gjatë transportit.

3.1.1.7 Ofruesi i Shërbimit nuk merr përsipër kryerjen e shërbimit për objekte që paraqesin rrezikshmëri gjatë transportit për jetën e njerëzve, si dhe vlera monetare, armë zjarri, lëndë radioaktive, lëndë djegëse, lëndë biologjike, drogë, sende të çmuara ari, para, letra me vlerë etj.

3.1.1.8 Ofruesi i Shërbimit i garanton agjencisë se, personeli qe ai vendos në dispozicion të agjencisë për ofrimin e shërbimit, është deklaruar rregullisht në organet tatimore dhe në Institutin e Sigurimeve Shoqërore në përputhje me ligjet përkatëse.

### 3.1.2 Për shërbimin e shpejtë postar EMS

3.1.2.1 Të marrë në dorëzim objektet postare pranë zyrave të Përfituesit të Shërbimit, si dhe të bëjë dorëzimin e objekteve të ardhura për llogari të Përfituesit të Shërbimit.

3.1.2.2 T'i japë Përfituesit të Shërbimit kopjen e faturës pas pranimit të objektit.

3.1.2.3 Të kryejë me cilësi dërgimin e objektit në destinacion duke respektuar afatin e përcaktuar në Aneksin 1.

3.1.2.4 Në rast humbje të objektit nga ana e Ofruesit të Shërbimit, e vërtetuar kjo me reklamacion, ky i fundit është i detyruar të paguajë dëmshpërblimin në përputhje me tarifat e miratuara të dëmshpërblimit për shërbimin EMS.

3.1.2.5 Ofruesi i Shërbimit, nuk mban përgjegjësi për mos realizimin e shërbimit apo vonesa në kryerjen e tij, në rast se nga ana e Përfituesit të Shërbimit nuk janë plotësuar të dhënat e mëposhtme:

- Adresa e marrësit nuk është e shkruar qartë dhe e plotë;
- Adresa është gabim;
- Kur amballazhimi nuk i përshtatet përmbajtjes së objektit, duke u bërë shkak për dëmtime gjatë transportit.

3.1.2.6 Ofruesi i Shërbimit nuk merr përsipër kryerjen e shërbimit për objekte që paraqesin rrezikshmëri gjatë transportit për jetën e njerëzve, si dhe vlera monetare, armë zjarri, lëndë radioaktive, lëndë djegëse, lëndë biologjike, drogë, sende të çmuara ari, para, letra me vlerë etj.

### 3.1.3 Për shërbimin e shpejtë brenda vendit (brenda qytetit dhe ndërmjet qyteteve)

3.1.3.1 Të tërheqë nga Përfituesi i Shërbimit objektet postare pranë zyrave të tij, si dhe të bëjë dorëzimin e objekteve të ardhura për llogari të Përfituesit të Shërbimit brenda 2 (dy) orëve për objektet brenda qytetit dhe të nesërmen deri në orën 10.00për objekte ndërmjet qyteteve.

3.1.3.2 Të trajtojë, e tarifojë objektin, duke e kategorizuar, si objekt postar:

- Ekspres brenda qytetit
- Ekspres ndërmjet qyteteve

3.1.3.2 T'i japë Përfituesit të Shërbimit kopjen e dëftesës së pranim konfirmim marrjes pas pranimit të objektit.

3.1.3.3 Të kryejë me cilësi dërgimin e objektit në destinacion duke respektuar afatin e përcaktuar në Aneksin1

3.1.3.4 T'i kthejë Ofruesit të Shërbimit, kopjen e dëftesës së pranim konfirmim marrjes pas dorëzimit të objektit, me nënshkrimin e marrësit.

3.1.3.5 Të paraqesë detajet e dorëzimit të objektit sipas kërkesave të Përfituesit të Shërbimit dhe normativave të përcaktuara nga Ofruesi i Shërbimit.

3.1.3.6 Ofruesi i Shërbimit, nuk mban përgjegjësi për mos realizimin e shërbimit apo vonesa në kryerjen e tij, në rast se nga ana e Përfituesit të Shërbimit nuk janë plotësuar të dhënat e mëposhtme:

- Adresa e marrësit nuk është shkruar qartë dhe e plotë;
- Adresa është gabim;
- Kur amballazhimi nuk i përshtatet përmbajtjes së objektit që përmban dërgesa, duke u bërë shkak për dëmtime gjatë transportit.

3.1.3.7 Në rast humbje të objektit nga ana e Ofruesit të Shërbimit, e vërtetuar kjo me reklamacion, ky i fundit është i detyruar të paguajë dëmshpërblimin në përputhje me tarifat e miratuara të dëmshpërblimit për shërbimin ekspres.

3.1.3.8 Ofruesi i Shërbimit nuk merr përsipër kryerjen e shërbimit për objekte që paraqesin rrezikshmëri gjatë transportit për jetën e njerëzve, si dhe vlera monetare, armë zjarri, lëndë radioaktive, lëndë djegëse, lëndë biologjike, drogë, sende të çmuara ari, para, letra me vlerë etj.

**3.2 Përfituesi i Shërbimit**

3.2.1 Të dorëzojë objektin postar pranë personit të autorizuar nga Ofruesi i Shërbimit kundrejt nënshkrimit përkatës (emër, mbiemër, firmën e tij) për shërbimet bazë postare.

3.2.2 Dorëzimi i objektit do të bëhet konform afateve kohore të punës së Ofruesit të Shërbimit.

3.2.3 Për shërbimin ekspres të brendshëm të njoftojë Ofruesin e Shërbimit për tërheqjen e objekteve postare ekspres në kontaktet telefonike; ***2455749, 2455748 dhe 2378493*** dhe të dorëzojë objektin postar pranë personit të autorizuar nga Përfituesi i Shërbimit kundrejt nënshkrimit përkatës (emër, mbiemër dhe firmën e tij) **brenda orës 17.00 nga e hëna në të shtunë.**

3.2.4 Të sigurojë mire ambalazhimin e objektit me qëllim garantimin e transportit pa dëmtuar objektin

3.2.5 Te sigurojë që adresat të jenë të qarta, të plota dhe pa gabime.

## Neni 4
## Kostoja dhe Mënyra e Pagesës

4.1 Vlefta e shërbimit të kësaj kontratë, do të llogaritët sipas tabelave të tarifave të shërbimit të miratuar nga organi vendimarrës i Ofruesit të Shërbimit, të cilat i bashkangjiten dhe janë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Ofruesi i Shërbimit harton brenda datës 5 (pesë) të muajit pasardhës faturën e shërbimit konform rregullave e ligjeve dhe ja paraqet Përfituesit të Shërbimit.

4.3 Pagesa e shërbimit të kryer nga Ofruesi i Shërbimit do të bëhet nga ana e Përfituesit të Shërbimit në një nga numrat e llogarisë të Filialit të Postave Tiranë, si me poshtë: në Raiffeisen Bank në nr e llogarisë 0100004382 IBAN AL18202110130000000100004382; në Bankën Kombëtare Tregëtare në numrin e llogarisë 637 IBAN AL66205110140000637CLPBCL ALL0; në Credins Bank në numrin e llogarisë 20855 IBAN AL71212110160000000000020855; në Tirana Bank në numrin e llogarisë 0120-302505-100 IBAN AL61206110280000120302505100; Intesa Sanpaolo në numrin e llogarisë 20019635305 IBAN AL03208110080000020019635305 për shërbimin postar bazë për jashtë vendit dhe në Filialin e Qendrës Tranzite Tiranë, për shërbimin e shpejtë jashtë vendit, në një nga numrat e llogarisë së mëposhtme: në Raiffeisen Bank, Iban AL10 5000 0873, IBAN AL22 2021 1013 0000 0010 5000 0873; Nr. llog. 0490000873; në Credins Bank në numrin e llogarisë

00000088000 IBAN AL 86212110160000000000088000; në Bankën Kombëtare Tregëtare në numrin e llogarisë 512144739; Iban 15205116291447739CLPBCLALLA; në Tirana Bank në numrin e llogarisë 0170305881-100 IBAN AL48206110730000170305881100 sipas faturave mujore të lëshuara nga këto filiale për shërbimet e kryera.

4.4 Pagesa për shërbimin e kryer, do të realizohet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e lëshimit të faturës.

4.5 Tarifat e përcaktuara në këtë kontratë janë të pandryshueshme, me përjashtim të rasteve kur një ndryshim i tillë bëhet nga organet vendimarrëse të Ofruesit të Shërbimit.

4.6 Në të gjitha rastet e ndryshimit të tarifave, Ofruesi i Shërbimit është i detyruar të njoftojë Përfituesin e Shërbimit të paktën 2 (dy) javë përpara

## Neni 5
## Kohëzgjatja

5.1 Kjo kontratë do të jetë e vlefshme deri në 5 (pesë) vjet duke filluar nga data 11.12.2019

5.2 Në rast se palët nuk do të kenë ndonjë pretendim lidhur me kushtet e kësaj kontrate, deri jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga përfundimi i saj, kontrata do të mbetet në fuqi edhe pas mbarimit të këtij afati, deri në nënshkrimin e kontratës së re.

5.3 Në çdo rast tjetër, afati i paralajmërimit për zgjidhjen e kontratës nuk do të jetë (më pak se 30 tridhjetë ditë kalendarike).

## Neni 6
## Likujdimi i dëmeve për Vonesat

6.1 Nëse vonesat për likujdimin e faturës mujore vijnë si rezultat i mosdorëzimit në afat të faturës nga ana e Ofruesit të Shërbimit, Përfituesi i Shërbimit përjashtohet nga detyrimi i pagesës së penaliteteve, per ato ditë sa zgjat kjo vonesë.

6.2 Nëse Ofruesi i Shërbimit nuk zbaton me korrektësi pikën 3.1. të kontratës e vërtetuar me dokumentin përkatës atëherë ai detyrohet t'i paguajë Përfituesit të Shërbimit 0.002% të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë.

6.3 Nëse Përfituesi i Shërbimit me paraqitjen e faturës së shërbimit vonon pagesën e shërbimit siç është parashikuar atëherë ai detyrohet t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve **0.002%** të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë.

## Neni 7
## Ndryshimet dhe zgjidhja e kontratës

7.1 Palët mund të bëjnë ndryshime në kontratë të cilat mund të vijnë vetëm për ndryshim të tarifave
me vendim te AKEP ose organit vendimarrës të Ofruesit të Shërbimit.

7.2 Në të gjitha rastet e ndryshimit te tarifave, Ofruesi i Shërbimit është i detyruar të njoftojë Përfituesin e Shërbimit të paktën 2(dy) javë përpara.

7.3 Secila palë ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata kur pala tjetër nuk respekton të gjitha kushtet e
kësaj kontratë dhe veçanërisht nëse kemi:

- Humbje të shpeshta të objektit postar
- Kur Përfituesi i Shërbimit përdor subjekte të tjera private, për ofrimin e këtyre shërbimeve, gjatë kohës që është në fuqi kjo kontratë shërbimi.

7.4 Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës duke njoftuar palën tjetër 30 (tridhjetë) ditë përpara.

## Neni 8
## Komunikimi Ndërmjet Palëve

8.1 I gjithë komunikimi ndërmjet Palëve në lidhje me këtë Kontratë duhet të shkëmbehet në formë të shkruar si dhe të dergohet me postë të regjistruar ose me faks në adresat e mëposhtme:

**QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN**
Në vëmendje të: Z Karafil Ahmeti
Titulli: Specialist në Sektorin e Botimeve dhe Shpërndarjes
E-mail: Karafil.Ahmeti@qbd.gov.al
Tel:0696744848

**POSTA SHQIPTARE SHA**
Rr "Reshit Çollaku", Nr 4, Tiranë
Në vëmendje të: Z. Dritan Monka
Drejtor i Shërbimeve Postare
E – mail: dritan.monka@postashqiptare.al
Tel: +355 4 2222 315 / 128

8.2 Secila Palë është e detyruar të njoftojë menjëherë Palën tjetër në rast të ndonjë ndryshimi në adresat e lartpërmendura si dhe çdo ndryshim tjetër që mund të ndikojë komunikimin ndërmjet Palëve.

8.3 Çdo njoftim i bërë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim. Njoftimi duhet të ketë efekt sapo të dorëzohet.

## Neni 9
## Dispozita përfundimtare

9.1 Palët nënshkruese të kësaj kontrate, nuk mbajnë përgjegjësi për mos zbatimin e kushteve të kontratës për aq kohë sa ekzistojnë forcat madhore për të cilën palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim.

9.2 Sipas kësaj kontrate me forca madhore do të nënkuptohet fatkeqësi natyrore, zjarri, përmbytje ujore etj. Nëqoftëse forca madhore do të veprojë më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë, kontrata konsiderohet e prishur nga të dyja palët duke paralajmëruar njëri - tjetrin me shkrim.

9.3 Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve. Në rast se këto mosmarrëveshje nuk do të zgjidhen në këtë mënyrë, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

9.4 Kontrata përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën Shqipe.

9.5 Palët, pasi njihen me detyrimet dhe të drejtat që lidhen me zbatimin e kësaj kontrate, e nënshkruajnë atë pa vërejtje.

## Neni 10
## Sfera e Marrëveshjes

10.1 Me nënshkrimin e kontratës palët bien dakort për termat e saj. Ndryshimi apo modifikimi i kushteve kontraktuale bëhet i vlefshëm vetëm pasi të jetë bërë me shkrim dhe të jetë firmosur nga të dy palët.

10.2 Kopjet e kontratës dhe aneksit bashkëlidhur, firmosen dhe vulosen nga të dy palët.

**PALËT KONTRAKTUESE**

| POSTA SHQIPTARE SH.A | QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN |
|---|---|
| Laert Duraj | Mimoza Hysa Çuliqi |
| ADMINISTRATOR | |

## ANEKSI 1

Tarifat e pranimit të objekteve postare për brenda vendit, të thjeshta dhe të porositura

Në lekë

| Lloji i objektit | Pesha në gram | E thjeshtë | E porositur |
|---|---|---|---|
| Letra | Deri 20 gr | 40 | 70 |
| | 21 – 50 | 50 | 80 |
| | 51 – 100 | 55 | 85 |
| | 101 – 250 | 60 | 90 |
| | 251 - 500 | 70 | 100 |
| | 501 – 1000 | 75 | 105 |
| | 1001 - 2000 | 80 | 110 |
| Kartë postare dhe kartolina | | 20 | |

Tabela e pranimit të shtypshkrimeve për brenda vendit, të thjeshta dhe të porositura

Në lekë

| | | | |
|---|---|---|---|
| Shtypshkrime | deri 50 gr | 20 | 50 |
| | 51-100 | 30 | 60 |
| | 101-250 | 40 | 70 |
| | 251-500 | 50 | 80 |
| | 501-1000 | 60 | 90 |

Shënim: Për shtypshkrimet me peshë mbi 1000 gr deri në 5 kg, për çdo 1000 gr ose pjesë të tij merret një tarifë shtësë prej 30 lekësh.

Tabela e pranimit të paketave të vogla për brenda vendit

Në lekë

| Lloji i objektit | Pesha në gram | E thjeshtë | E porositur |
|---|---|---|---|
| Paketa të vogla | 250 | 50 | 80 |
| | 251 – 500 | 70 | 90 |
| | 501 – 1000 | 80 | 110 |
| | 1001 - 2000 | 200 | 230 |

Shënim: Tarifat e pranimit të cekogrameve deri 7000 gram për brenda vendit janë pa pagesë. Cekogramet pranohen pa pagesë kur ato bëhen nga të verbërit, me kusht që këto të dërgohen nga një institut.

Tarifa e pranimit të kolipostave të zakonshme dhe kolipostave kaba për brenda vendit

Në lekë

| Lloji i objektit | Pesha në gram | Tarifa |
|---|---|---|
| Koliposte e zakonshme | 1 kg | 60 |
| | 1 – 3 kg | 90 |
| | 3 – 5 kg | 100 |
| | 5 – 10kg | 130 |
| | 10 – 15 kg | 150 |
| | 15 – 20 kg | 170 |
| Koliposta kaba | 1 kg | 80 |
| | 1 – 3 kg | 100 |
| | 3 – 5 kg | 130 |
| | 5 – 10kg | 150 |
| | 10 – 15 kg | 180 |
| | 15 – 20 kg | 200 |

Tabela e pranimit të objekteve postare për jashtë shtetit që vijohen në rrugë ajrore

Në lekë

| Lloji i objektit | Pesha | | Kontinentët | | Fqinjët |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Europë | Azi / Afrikë | Amerikë / Australi | |
| Letra të thjeshta | Kohëzgjatja në ditë | 6 – 8 ditë | 8 – 10 ditë | 8 – 10 ditë | 3 – 5 ditë |
| | deri 20 gr | 130 | 140 | 150 | 90 |
| | 21 – 50 | 140 | 190 | 200 | 120 |
| | 51 – 100 | 220 | 300 | 280 | 180 |
| | 101 – 250 | 400 | 580 | 520 | 300 |
| | 251 - 500 | 700 | 1000 | 1100 | 500 |
| | 501 – 1000 | 1300 | 2000 | 2300 | 1000 |
| | 1001 - 2000 | 2400 | 3900 | 3900 | 2000 |
| Kartolina, kartë postare | | 90 | 100 | 100 | 70 |
| Paketa të vogla të thjeshta | deri 100 | 200 | 300 | 320 | 150 |
| | 101-250 | 400 | 560 | 530 | 300 |
| | 251-500 | 600 | 1100 | 1300 | 550 |
| | 501-1000 | 1350 | 2100 | 2500 | 1100 |
| | 1001-2000 | 2400 | 4000 | 4200 | 2200 |

Shënim: Kur letrat dhe paketat kërkohen me shërbime të tjera të veçanta shtohen tarifat sipas tabelës së shërbimeve të veçanta për shërbimet postare ndërkombëtare. Tek fqinjët bëjnë pjesë Maqedonia, Greqia, Mali I Zi dhe Kosova

Tarifa e pranimit të objektëve postare për jashtë shtetit që vijohen në rrugë ajrore

Në lekë

| Lloji i objektit | Pesha në gr | Europë | Azi / Afrikë | Amerikë / Australi | Fqinjët |
|---|---|---|---|---|---|
| | Kohëzgjatja në ditë | 6 – 8 ditë | 8 – 10 ditë | 8 – 10 ditë | 3 – 5 ditë |
| Shtypshkrime të thjeshta | deri 20 | 110 | 120 | 130 | 80 |
| | 21-50 | 120 | 170 | 200 | 100 |
| | 51-100 | 200 | 200 | 260 | 160 |
| | 101-250 | 300 | 500 | 500 | 250 |
| | 251-500 | 500 | 1000 | 1000 | 500 |
| | 501-1000 | 1100 | 1800 | 2200 | 1000 |
| | 1001-2000 | 2200 | 3800 | 3900 | 1800 |
| Thase speciale "M" | deri 5 kg | 4000 | 7500 | 6000 | 1500 |
| | 5-10 kg | 7000 | 14000 | 12000 | 2000 |
| | 10-15 kg | 10000 | 17500 | 18000 | 3500 |
| | 15-20 kg | 13000 | 28000 | 23000 | 4500 |
| | 20-30 kg | 19500 | 42000 | 35000 | 6500 |

Shënim: Shtypshkrimet pranohen deri në 5 kg. Mbi 2000gr për çdo 1000 gr ose pjesë të tij merret një tarifë shtesë prej 1500 lekë.
Kur shtypshkrimet dhe thasët M kërkohen me shërbime të veçanta shtohen tarifat përkatëse sipas llojit të shërbimit të përcaktuar në tabelën e shërbimeve të veçanta për shërbimet postare ndërkombëtare.

Tarifat e pranimit të kolipostave për jashtë shtetit që vijohen në rruge ajrore sipas kontinenteve

Në lekë

| Lloji i objektit | Pesha në kg | Europë | Azi | Afrikë | Amerikë |
|---|---|---|---|---|---|
| | Kohëzgjatja në ditë | 6 – 8 ditë | 8 – 10 ditë | 8 – 10 ditë | 8 – 10 ditë |
| | deri 1 kg | 3000 | 3500 | 3200 | 4000 |
| Kolipostë | 1-3 kg | 4000 | 6000 | 6000 | 6500 |
| | 3-5 kg | 6000 | 9000 | 9000 | 10000 |
| | 5-10 kg | 7000 | 13000 | 12000 | 18000 |
| | 10-15 kg | 9000 | 18000 | 15000 | 26000 |
| | 15-20 kg | 11000 | 24000 | 20000 | 35000 |

| TARIFAT E SHËRBIMIT EKSPRES NDËRMJET QYTETEVE (ENQ) | |
|---|---|
| Pesha e objektit | Tarifa në lekë |
| deri në 150 gr | 400 |
| 151-250 gr | 500 |
| 251-350gr | 600 |
| 351-500gr | 700 |
| 501gr-2kg | 850 |
| 2kg-5kg | 1000 |
| 5kg-7kg | 1200 |
| 7kg-10kg | 1400 |

| TARIFAT E SHËRBIMIT EKSPRES BRENDA QYTETIT (EBQ) | |
|---|---|
| Pesha e objektit | Tarifa në lekë |
| deri në 500gr | 200 |
| 501gr-1kg | 300 |
| 1kg-2kg | 400 |
| 2kg-5kg | 600 |
| 5kg-7kg | 750 |
| 7kg-10kg | 1000 |

TARIFA PËR SHËRBIMET E VEÇANTA PËR OBJEKTET POSTARE E KOLIPOSTARE

| Nr. | Lloji i shërbimit të veçantë | Brenda Vendit | Ndërkombëtare |
|---|---|---|---|
| 1 | Objekt i porositur | | 180 |
| 2 | Ekspres | 100 | 300 |
| 3 | Lajmërim marrje në kohën e postimit të objektit me kthim të porositur | 50 | 100 |
| 4 | Lajmërim marrje pas postimit të objektëve | 50 | 200 |
| 5 | Lajmërim marrje me komunikim gjyqi | 50 | |
| 6 | Dorëzim marrësit në dore | 70 | 100 |
| 7 | Lajmërim mosdorëzim objekti | 50 | 100 |
| 8 | Kërkesë kthimi, ndryshim drejtimi të objekteve | 60 | 200 |
| 9 | Reklamim për objekte të porositura, koliposta, UPP | 60 | 150 |
| 10 | Pajtim me kutitë postare të mbyllura me çelës çdo muaj | 250 | |
| 11 | Lëshim dublikate për dëftesa të shërbimit postar | 50 | |
| 12 | Magazinim për kolipostat e zakonshme për çdo ditë | 30 | 30 |
| 13 | Magazinim për kolipostat me vlerë të deklaruar për çdo ditë | 50 | 100 |
| 14 | Njoftim mbërritje për kolipostat | 50 | 50 |
| 15 | Riamballazhim kolipostash deri në 5 kg | 50 | 120 |
| 16 | Nga 5-10 kg | 100 | 250 |
| 17 | Nga 10 – 20 kg | 120 | 350 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 18 | Tërheqja e objekteve ose dërgesave në adresën e dërguesit brenda qytetit. | 150 | |
| 19 | Njoftim për mbërritje paketa të vogla | | 30 |
| 20 | Post restant për objektet e postës së letrave për jashtë | | 50 |

**Tariifat për shërbim EMS**

| Nr | Pesha në gr | Zona I<br>Tarifa në lekë | ZONA II<br>Tarifa në lekë | ZONA III<br>Tarifa në lekë | ZONA IV<br>Tarifa në lekë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | deri 250 gr | 3500 | 4000 | 4500 | 6000 |
| 2 | 251-500 | 3600 | 4500 | 5000 | 7500 |
| 3 | 501-1000 | 4500 | 5000 | 5800 | 8250 |
| 4 | 1001-1500 | 5000 | 5500 | 6900 | 9750 |
| 5 | 1501-2000 | 6000 | 6000 | 7600 | 10800 |
| 6 | 2001-2500 | 6500 | 7300 | 8300 | 12750 |
| 7 | 2501-3000 | 7000 | 8000 | 9000 | 14700 |
| 8 | 3001-3500 | 7600 | 8500 | 9800 | 16350 |
| 9 | 3501-4000 | 8400 | 9400 | 11300 | 17700 |
| 10 | 4001-4500 | 8600 | 10100 | 12000 | 19350 |
| 11 | 4501-5000 | 9000 | 10800 | 12800 | 20850 |
| 12 | 5001-5500 | 9500 | 11600 | 13500 | 21750 |
| 13 | 5501-6000 | 9800 | 12000 | 14500 | 23250 |
| 14 | 6001-6500 | 10000 | 12600 | 15000 | 24750 |
| 15 | 6501-7000 | 10600 | 13200 | 15800 | 26250 |
| 16 | 7001-7500 | 11000 | 14000 | 17000 | 27000 |
| 17 | 7501-8000 | 11300 | 14300 | 17300 | 27750 |
| 18 | 8001-8500 | 11700 | 15000 | 18000 | 28500 |
| 19 | 8501-9000 | 12200 | 15500 | 18800 | 29250 |
| 20 | 9001-9500 | 12800 | 16000 | 19500 | 30000 |
| 21 | 9501-10000 | 13800 | 17000 | 20300 | 30750 |

Për peshën nga 10 kg deri në 20 kg për çdo 1 (një) kilogram shtesë mbi dhjetë kilogram tarifat do të jenë si më poshtë:

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 22 | 10000-20000 | 1000 leke / kg | 1300 leke / kg | 1700 leke / kg | 2240 leke / kg |

**Ndarja në zona dhe kohëzgjatja për shërbimin EMS**

| Nr | Vendi | Zona I | Kohëzgjatja (Ditë) |
|---|---|---|---|
| 1 | Austria | 1 | 2 deri 3 |
| 2 | Anglia (GB) | 1 | 2 deri 3 |
| 3 | Belgjika | 1 | 2 deri 3 |
| 4 | Bosnjë & Hercegovina | 1 | 2 deri 3 |
| 5 | Bullgaria | 1 | 2 deri 3 |
| 6 | Çekia | 1 | 2 deri 3 |
| 7 | Danimarka | 1 | 2 deri 3 |
| 8 | Finlanda | 1 | 2 deri 3 |
| 9 | Franca | 1 | 2 deri 3 |
| 10 | Gjermania | 1 | 2 deri 3 |
| 11 | Gjilbraltari | 1 | 2 deri 3 |
| 12 | Greqia | 1 | 2 dite |
| 13 | Hollanda | 1 | 2 deri 3 |
| 14 | Hungaria | 1 | 2 deri 3 |
| 15 | Irlanda | 1 | 2 deri 3 |
| 16 | Islanda | 1 | 2 deri 3 |
| 17 | Italia | 1 | 2 dite |
| 18 | Serbia | 1 | 2 deri 3 |
| 19 | Kroacia | 1 | 2 deri 3 |
| 20 | Letonia | 1 | 2 deri 3 |
| 21 | Lituania | 1 | 2 deri 3 |
| 22 | Luksenburgu | 1 | 2 deri 3 |
| 23 | Malta | 1 | 2 deri 3 |
| 24 | Maqedonia | 1 | 2 dite |
| 25 | Moldavia | 1 | 4 deri 5 |
| 26 | Norvegjia | 1 | 2 deri 3 |
| 27 | Polonia | 1 | 2 deri 3 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 28 | Portugalia | 1 | 2 deri 3 |
| 29 | Qipro | 1 | 2 deri 3 |
| 30 | Rumania | 1 | 2 deri 3 |
| 31 | Rusia | 1 | 2 deri 3 |
| 32 | Sllovaki | 1 | 2 deri 3 |
| 33 | Slloveni | 1 | 2 deri 3 |
| 34 | Spanjë | 1 | 2 deri 3 |
| 35 | Suedi | 1 | 2 deri 3 |
| 36 | Turqi | 1 | 2 deri 3 |
| 37 | Ukraina | 1 | 4 deri 5 |
| 38 | Zvicra | 1 | 2 ditë |
| **Nr** | **Vendi** | **Zona II** | **Kohëzgjatja (Ditë)** |
| 1 | Algjeria | **2** | **3 deri 4** |
| 2 | Biellorusia | 2 | 3 deri 4 |
| 3 | Egjipt | 2 | 2 deri 3 |
| 4 | Estonia | 2 | 3 deri 4 |
| 5 | Gjeorgjia | 2 | 4 deri 5 |
| 6 | Izraeli | 2 | 4 deri 5 |
| 7 | Libani | 2 | 3 deri 4 |
| 8 | Maroku | 2 | 3 deri 4 |
| 9 | Siria | 2 | 3 deri 4 |
| 10 | Sudani | 2 | 4 deri 5 |
| 11 | Taxhikistani | 2 | 4 deri 5 |
| 12 | Uzbekistani | 2 | 5 deri 6 |
| | | | |
| **Nr** | **Vendi** | **Zona III** | **Kohëzgjatja (Ditë)** |
| 1 | Afrika e Jugut | 3 | 3 deri 4 |
| 2 | Afrika Qëndrore | 3 | 3 deri 4 |
| 3 | Angola | 3 | 3 deri 4 |
| 4 | Andore | 3 | 2 deri 3 |
| 5 | Arabia Saudite | 3 | 3 deri 4 |
| 6 | Armenia | 3 | 4 deri 5 |
| 7 | Aruba | 3 | 3 deri 4 |
| 8 | Azerbajxhani | 3 | 3 deri 4 |
| 9 | Bahama | 3 | 3 deri 4 |
| 10 | Emiratet e Bashkuara | 3 | 3 deri 4 |
| 11 | Etiopia | 3 | 5 deri 6 |
| 12 | Hong Kong | 3 | 3 deri 4 |
| 13 | India | 3 | 4 deri 5 |
| 14 | Iraku | 3 | 3 deri 4 |
| 15 | Irani | 3 | 3 deri 4 |
| 16 | Japonia | 3 | 3 deri 4 |
| 17 | Jemeni | 3 | 4 deri 5 |
| 18 | Jordania | 3 | 2 deri 3 |
| 19 | Kamboxhia | 3 | 5 deri 7 |
| 20 | Kanadaja | 3 | 3 deri 4 |
| 21 | Kazakistani | 3 | 4 deri 5 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 22 | Kenia | 3 | 3 deri 4 |
| 23 | Kina | 3 | 4 deri 5 |
| 24 | Kirgistani | 3 | 4 deri 5 |
| 25 | Kongo | 3 | 3 deri 4 |
| 26 | Korea e Jugut | 3 | 3 deri 4 |
| 27 | Kuvajti | 3 | 3 deri 4 |
| 28 | Laosi | 3 | 5 deri 6 |
| 29 | Lesoto | 3 | 4 deri 5 |
| 30 | Liberia | 3 | 4 deri 5 |
| 31 | Madegaskari | 3 | 3 deri 5 |
| 32 | Malajzia | 3 | 4 deri 5 |
| 33 | Mongolia | 3 | 4 deri 5 |
| 34 | Mozanbiku | 3 | 4 deri 5 |
| 35 | Namibia | 3 | 4 deri 5 |
| 36 | Nezali | 3 | 4 deri 5 |
| 37 | Nigeri | 3 | 4 deri 5 |
| 38 | Nigeria | 3 | 3 deri 4 |
| 39 | Omani | 3 | 3 deri 4 |
| 40 | Pakistani | 3 | 3 deri 5 |
| 41 | Ruanda | 3 | 4 deri 7 |
| 42 | Senegali | 3 | 3 deri 4 |
| 43 | Sierra Leone | 3 | 3 deri 4 |
| 44 | Singapori | 3 | 3 deri 4 |
| 45 | Somalia | 3 | 3 deri 4 |
| 46 | Srilanka | 3 | 3 deri 4 |
| 47 | Suazilandi | 3 | 3 deri 4 |
| 48 | Surinami | 3 | 4 deri 5 |
| 49 | St. Pierre & Mikelon | 3 | 5 deri 6 |
| 50 | Taivani | 3 | 5 deri 6 |
| 51 | Tailanda | 3 | 3 deri 4 |
| 52 | Tanzania | 3 | 3 deri 4 |
| 53 | Togo | 3 | 3 deri 4 |
| 54 | Trinidad Tabago | 3 | 3 deri 4 |
| 55 | Turkmenistan | 3 | 4 deri 5 |
| 56 | Uganda | 3 | 5 deri 6 |
| 57 | U.S.A | 3 | 3 deri 4 |
| 58 | Vietnami | 3 | 4 deri 6 |
| 59 | Xhamajka | 3 | 3 deri 4 |
| 60 | Zaire | 3 | 3 deri 5 |
| 61 | Zambia | 3 | 5 deri 6 |
| 62 | Zimbabia | 3 | 3 deri 4 |
| **Nr** | **Vendi** | **Zona IV** | **Kohëzgjatja (Ditë)** |
| 1 | Argjentina | 4 | 3 deri 4 |
| 2 | Australia | 4 | 4 deri 5 |
| 3 | Baheireni | 4 | 3 deri 4 |
| 4 | Bangladeshi | 4 | 4 deri 5 |
| 5 | Barbadosi | 4 | 3 deri 4 |
| 6 | Benini | 4 | 4 deri 5 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 7 | Bermuda | 4 | 3 deri 4 |
| 8 | Bhutani | 4 | 5 deri 6 |
| 9 | Bolivia | 4 | 3 deri 4 |
| 10 | Bregu i Fildishtë | 4 | 2 deri 3 |
| 11 | Botsvana | 4 | 3 deri 4 |
| 12 | Brazili | 4 | 3 deri 4 |
| 13 | Brunei | 4 | 4 deri 5 |
| 14 | Burkina Faso | 4 | 5 deri 6 |
| 15 | Burundi | 4 | 3 deri 4 |
| 16 | Cadi | 4 | 4 deri 5 |
| 17 | Rep. Domenikane | 4 | 3 deri 4 |
| 18 | Ekuadori | 4 | 3 deri 4 |
| 19 | El Salvadori | 4 | 3 deri 4 |
| 20 | Eritrea | 4 | 3 deri 4 |
| 21 | Filipinet | 4 | 3 deri 4 |
| 22 | Fixhi, Ishujt | 4 | 4 deri 5 |
| 23 | Gaboni | 4 | 4 deri 5 |
| 24 | Gambia | 4 | 3 deri 4 |
| 25 | Gana | 4 | 4 deri 5 |
| 26 | Guadelope | 4 | 3 deri 4 |
| 27 | Guajana | 4 | 3 deri 4 |
| 28 | Guajana Franceze | 4 | 5 deri 7 |
| 29 | Guam (USA) | 4 | 3 deri 4 |
| 30 | Guatemala | 4 | 3 deri 4 |
| | | | |
| 31 | Guinea - Bisau | 4 | 4 deri 5 |
| 32 | Guinea Ekuatoriale | 4 | 3 deri 4 |
| 33 | Guinea, Republika | 4 | 5 deri 6 |
| 34 | Haiti | 4 | 3 deri 4 |
| 35 | Honduras | 4 | 3 deri 4 |
| 36 | Indonezia | 4 | 4 deri 5 |
| 37 | Kaledonia e Re | 4 | 4 deri 5 |
| 38 | Kameruni | 4 | 3 deri 4 |
| 39 | Katari, Ishujt | 4 | 3 deri 4 |
| 40 | Kepi i Gjelber | 4 | 4 deri 6 |
| 41 | Kili | 4 | 3 deri 4 |
| 42 | Kolumbia | 4 | 3 deri 4 |
| 43 | Kosta Rika | 4 | 3 deri 4 |
| 44 | Kuba | 4 | 3 deri 4 |
| 45 | Makau | 4 | 4 deri 5 |
| 46 | Malaui | 4 | 3 deri 4 |
| 47 | Mali | 4 | 4 deri 5 |
| 48 | Marshall Ishujt | 4 | 3 deri 4 |
| 49 | Martinikua | 4 | 3 deri 4 |
| 50 | Mauritania | 4 | 4 deri 5 |
| 51 | Maurisi | 4 | 5 deri 6 |
| 52 | Meksika | 4 | 4 deri 5 |
| 53 | Neuri | 4 | 4 deri 5 |
| 54 | Nikaragua | 4 | 3 deri 4 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 55 | Panamaja | 4 | 3 deri 4 |
| 56 | Paraguaji | 4 | 3 deri 4 |
| 57 | Papua, Guinea e Re | 4 | 4 deri 5 |
| 58 | Peruja | 4 | 3 deri 4 |
| 59 | Porto Riko (USA) | 4 | 3 deri 4 |
| 60 | Reunion Ishujt | 4 | 4 deri 5 |
| 61 | Samoa (USA) | 4 | 3 deri 4 |
| 62 | Seishell | 4 | 4 deri 5 |
| 63 | Solomon Ishujt | 4 | 4 deri 5 |
| 64 | Uruguai | 4 | 3 deri 4 |
| 65 | Vanuatu | 4 | 4 deri 5 |
| 66 | Venezuela | 4 | 3 deri 4 |
| 67 | Virxhin, Ishujt (USA) | 4 | 3 deri 4 |
| 68 | Xhibuti | 4 | 4 deri 6 |
| 69 | Zelanda e Re | 4 | 4 deri 5 |
| **Totali** | **181 Shtete** | | |